



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijeno/Profato Received/Delivered	12.04.2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMBSHCK	2029/2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.167/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.167/2022 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankuesja

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.04.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.167/2022 e datës 25.02.2022, e parashtruar nga ankuesja

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me numër 111-169/1 i datës 24.02.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

**A r s y e t i m**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 16.12.2021 ka shpallur konkursin ngritje (avancim) në detyrë për vendin e numës “Udhëheqës për Komunikim me Publikun”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila e ka kënaqur me njoftimin e datës 14.02.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidaut me datë 21.02.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë (KVND) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë (KVND) me datë 24.02.2022 merr vendimin me numër 111-169/1 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankueses dhe mbetet në fuqi vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Mistrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ankuesja e ka kënaqur me Vendimin me numër 111-169/1 të datës 24.02.2022 të Komisionit të vlerësimit për Ngritje në Detyrë, me datë 25.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 990/2022.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 03.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa me datë 11.03.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/120.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankueses e datës 25.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 24.02.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Ankesa e ankueses e datës 21.02.2022 e parashtruar në Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Njoftimi i datës 14.02.2022 për kandidatin e suksesshëm; Konkursi i datës 16.12.2021; E-mail i datës 09.02.2022; Lista e aplikantëve; Njoftimi i datës 23.02.2022; Njoftim i datës 28.12.2021; Njoftimi për kandidatin fitues i datës 22.02.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Vendimi i datës 12.01.2022 për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Aplikacioni i kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur për përgatitje profesionale, përvojën e punës, vlerësimit si dhe certifikatat e trajnimit; Aplikacioni i kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur për përgatitje profesionale, përvojën e punës, vlerësimit si dhe certifikatat e trajnimit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 16.12.2022 ka shpallur konkursin për pozitën “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 39 paragrafi 1.2.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00007918 i shpallur me datë 16.12.2021, për pozitën “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Shkollimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në shkenca shoqërore, komunikim masiv ose në ndonjë fushë të përfaqshme, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Kualifikime të posaçme formale;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar katër (4) kandidatë, ndërsa tre (3) kandidatë i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe janë ranguar në listën e ngushtë, në mesin e tyre edhe ankuesja e cila për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me numër reference RAN0002053 e cila ka marrë pjesë në intervistën me gojë, por nuk është përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë sepse i ka pasur 69.66 pikë ndërsa kandidati fitues renditet i pari me 77.66 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila e ka kundërshtuar përzgjedhjen e kandidatit sa i përket përgatitjes profesionale dhe të përvojës së punës si dhe ka theksuar se pozita për vendin e punës “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” nuk ka qenë e shpallur në pajtim me katalogun e vendeve të punës të vitit 2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar sepse kandidati fituese i cili është ranguar i pari me 77.66 pikë i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit. Kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me numër 524 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik me të cilën dëshmohet se me datë 06.07.2007 ka mbaruar studimet themelore në Degën e Sociologjisë dhe mori titullin “Bachelor i Sociologjisë”, po ashtu posedon edhe Diplomën me numër 151 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik me të cilën dëshmohet se me datë 15.06.2010 mori titullin “Master i Sociologjisë” dhe sipas vërtetimit të lëshuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të datës 01.12.2021 vërtetohet se është punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal prej datës 01. 11.2010 dhe vazhdon të punoj si “Zyrtarë i Lartë për Dokumente Strategjike” në Divizionin për Koordinim të Politikave në kuadër të Departamentit për Integritete Evropiane dhe Koordinim të Politikave dhe po ashtu vërtetohet se ndaj kandidatit të përzgjedhur nuk ka ndonjë masë disiplinore, po ashtu kandidati ka bashkangjitur edhe vlerësimet e rezultatit të punës për dy (2) vitet e fundit.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë me rastin e përzgjedhjes së kandidatit fitues ka vepruar drejtë duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 dhe 39 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 58 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“Vlerësimi i kandidatëve, në procedurën e konkurimit për ngritjen në detyrë përfshin, sipas radhës: 1.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 1.2. vlerësimin e jetëshkrimit; dhe 1.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë.”* si dhe nenin 49, 60, 61 dhe 62 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sepse kandidati fituese i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara në konkursin e datës 16.12.2021-23.12.2021 për pozitën “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” dhe se ankuesja nuk ka precizuar fare se në bazë të cilave dispozita ligjore apo rregullore ka pasur shkelje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me numër 524 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik me të cilën dëshmohet se me datë 06.07.2007 ka mbaruar studimet themelore në Degën e Sociologjisë dhe mori titullin “Bachelor i Sociologjisë”, po ashtu posedon edhe Diplomën me numër 151 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik me të cilën dëshmohet se me datë 15.06.2010 mori titullin “Master i Sociologjisë” dhe sipas vërtetimit të lëshuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të datës 01.12.2021 vërtetohet se Ferid Kamberi është punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal prej datës 01.11.2010 dhe vazhdon të punoj si “Zyrtarë i Lartë për Dokumente Strategjike” në Divizionin për Koordinim të Politikave në kuadër të Departamentit për Integritete Evropiane dhe Koordinim të Politikave dhe po ashtu vërtetohet se ndaj kandidatit të përzgjedhur nuk ka ndonjë masë disiplinore, po ashtu kandidati ka bashkangjitur edhe vlerësimet e rezultatit të punës për dy (2) vitet e fundit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 77.66 pikë dhe se emërimi i kandidatit është bërë në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të nenit 51 paragrafit 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila ka pretenduar se konkursi për vendin e punës “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” është dashtë të shpallet sipas katalogut të vendeve të punës të vitit 2016 sepse sipas katalogut kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara janë: *“Diploma universitare, fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përfaqshme, 5 vite përvojë pune profesionale....”*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar pasi që me hyrje në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të Rregullores Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në

Shërbimin Civil është shfuqizuar Rregullorja Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të Rregullores Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit e datës 16.12.2021-23.12.2021 për pozitën “Udhëheqës për Komunikim me Publikun” me nr. reference RN00007918 është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 39 paragrafi 1,2 ,3, 4 , 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 52,56,57,58,59,60,61 dhe 62 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.167/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuases
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Qarkut
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Qarkut
- Arkivit të KPMSHCK-së.

